



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 169 prot.

Kamëz, më 25.11.2022

V E N D I M
Nr. 145. Datë 25.11.2022
M B I

“MIRATIMIN E VLERËS TË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR FAMILJET QË PREKEN NGA PROJEKTI: “REHABILITIMI I DIGËS SË LIQENIT TË PASKUQANIT DHE NDËRTIMI I PEDONALES DHE ZONAVE RE-KREATIVE TË LIQENIT TË PASKUQANIT”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 25.11.2022, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.129 Datë 25.11.2022 në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, Ligjit Nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”; Ligj nr.22/2018 “Për strehimin Social” VKM nr. 409 datë 15.06.2022 “Për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesve pa leje që nuk legalizohen”; Vendimit nr.132, datë 22.12.2021 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e detajimit të buxhetit të Bashkisë Kamëz për vitin 2022-2024; Këshilli Bashkiak Kamëz”;

V E N D O S I:

1.Miratimin e vlerës së subvencionimit të qirasë për familjet që preken nga projekti “*Rehabilitimi Digës së Liqenit të Paskuqanit*” dhe “*Ndërtimi Zonave re-kreative të Liqenit Paskuqanit*”, sipas strukturave të apartamenteve në territorin e Bashkisë Kamëz, si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Nr.Frymësh	Sasia	Çmimi mesatar (lekë pa tvsh)
1	Banesa me qira (Apartament tip garsonierë)	muaj	1-2	1	15,000
2	Banesa me qira (Apartament 1 + 1)	muaj	3-4	1	21,000
3	Banesa me qira (Apartament 2 + 1)	muaj	5	1	25,000
4	Banesa me qira (Apartament 3 + 1)	muaj	6-8	1	27,000



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

2.Vlera e subvencionimit të qirasë është e barasvlefshme me qiratë mesatare në treg sipas vlerave të paraqitura në këtë vendim.

3.Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

KRYETAR KËSHILLI

Hysen KOLDASHI